Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me

kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II:LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2		3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Platformë për analizën e sistemit, sipas Termave te References	Komplet	1			
2	Trajnimi, sipas Termave te References	Komplet	1			
3	Sherbim mirëmbajtje per 12 muaj, sipas Termave te References	Komplet	1			
					Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						
Nënshkrimi						
Vula						
Datë _____						

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁴Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁴ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

“Platformë për analizën e sistemit”, sipas Termave të References.

Afatet e ekzekutimit: 14 (katërmbedhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas përcaktimeve si vijon:

1	Platformë për analizën e sistemit, sipas Termave të References.			Brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës. Realizimi i parakohshëm është i pranueshëm.
2	Trajnimi, sipas Termave të References			Brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës. Realizimi i parakohshëm është i pranueshëm.
3	Shërbim mirëmbajtje për 12 muaj, sipas Termave të References			12 (dymbëdhjetë) muaj nga dorezimi i platformes për analizën e sistemit, sipas Termave të References.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Te pergjithshme	
1. Shperndarja e Flukseve te Fuqise.....	
2. Llogaritja e lidhjeve te shkurtera	
3. Analiza e ndjeshmerise se rrjetit	
4. Modelimi elementeve te Sistemit Elektroenergjetik	
5. Menaxhimi i modeleve te rrjetit.....	
6. Raportimi dhe vizualizimi.....	
7. Konvertuesi modeleve.....	
8. Analiza Kontigjencave.....	
9. Simulimet “Quasi Dinamike”	
10. Analiza Qendrueshmerise se tensionit	
11. Analiza cilesise dhe harmonikave	
12. Gjuhet e programimit	
Mirembajtja.....	
Trajnimi	

AKRONIMET:

SEE	Sistemi ElektroEnergjetik
IEC	Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik
IEEE	Instituti i Inxhinierëve Elektrikë dhe Elektronikë
ASCII	Standard kodimi i karaktereve për komunikimin elektronik
XML	Extensible Markup Language
CSV	Comma-separated values
ODBC	Open Database Connectivity
SVC	Static var compesation
PSS/E	Simulator i sistemit të energjisë
UCTE	Sindikata për koordinimin e transmetimit të energjisë elektrike
ENTSO-E	Rrjeti evropian i operatorëve të sistemit të transmetimit
CIM	Modeli i informacionit të përbashkët
CGMES	Standardi i shkëmbimit të modelit të përbashkët të rrjetit

Te pergjithshme

Ne boten e sotme moderne, besueshmeria, efikasiteti dhe qendrueshmeria e sistemeve te energjise jane te nje rendesie te madhe. Optimizimi dhe analiza e sistemeve te energjise jane bere detyra thelbesore per inxhinieret. Per te perballuar keto sfida, softuere te sofistikuar te analizes se sistemit te energjise perdoren si mjete te fuqishme, duke u ofruar inxhinierëve aftesine per te projektuar, simuluar dhe optimizuar rrjetet elektrike komplekse me saktesi dhe efikasitet.

Softueri i analizes se sistemit energjetik sherben si nje platforme gjithepershiresë per inxhinieret per te modeluar, simuluar dhe analizuar aspekte te ndryshme te sistemeve te energjise elektrike. Keto zgjidhje softuerike jane krijuar per te trajtuar funksionalitete te ndryshme, duke filluar nga analiza e gjendjes se qendrueshme deri te studimet te proceseve kalimtare te qendrueshmerise. Me aftesine per te simuluar kushte dhe skenare te ndryshem operimi, softueri i analizes se sistemit elektroenergjetik u mundeson inxhinierëve te vleresojne performancen e sistemit, te identifikojne problematikat e mundshme dhe te krijojne zgjidhje efektive per te rritur besueshmerine dhe efikasitetin e sistemit te transmetimit. Ne thelb te softueret te analizes se sistemit te energjise elektrike qendrojne algoritmet e avancuara matematikore dhe teknikat llogaritese. Keto algoritme i mundesojne softuerit te zgjidhe ekuacione komplekse qe simulojne rrjetet elektrike, duke marre parasysh faktore te tille si flukset e fuqise, qendrueshmeria e tensionit, analiza e lidhjeve te shkurtra.

Nje nga karakteristikat kryesore te softuerit te analizes se sistemit energjetik eshte aftesia e tij per te kryer analiza te gjendjes se qendrueshme. Kjo perfshin llogaritjen e rrjedhes se energjise elektrike permes rrjetit ne kushte normale funksionimi. Duke simuluar rrjedhen e fuqise, inxhinieret mund te percaktojne parametra te tille si nivelet e tensionit, flukset e fuqise aktive dhe reaktive dhe ngarkimin e linjes, duke siguruar qe sistemi te funksionojë brenda kufijve te sigurt dhe te plotesoje kerkesat e performances.

Platforma softuerike per Operatorin e Sistemit te Transmetimit duhet te kete keto module/aftesi:

Shperndarja e Flukseve te Fuqise

Platforma duhet te realizoje llogaritjen e shperndarjes se flukseve te fuqise, bazuar ne modelin matematikor te rrjetit, duke suportuar zgjidhje AC dhe DC te modelit (pa marre ne konsiderate fuqine reaktive). Metodot llogaritese numerike duhet te perfshijne te pakten metodat “Newton Raphson” dhe “Gauss-Seidel”, bazuar ne kushtet fillestare te modelit te rrjetit. Kontrolli i fuqise aktive dhe reaktive duhet te lejohet per pajisje si ngarkesa, gjenerator.

Nyja balancuese duhet te jete e konfigurueshme ne cdo tip nyje dhe me mundesi kontrolli lokal ose ne distance nga nje nyje tjeter. Platforma duhet te lejoje vendosjen e limiteve per secilin element qe modelohet, si dhe mundesine e vendosjes se limiteve globale. Gjithashtu nyjet e ngarkeses duhet te kene opsionin e rritjes se pershkallezuar te ngarkeses sipas zgjedhjes se perdoruesit. Pas cdo iteracioni te zgjidhjes numerike duhet te kete mundesi te shihet distanca nga konvergjenca.

Llogaritja e lidhjeve te shkurtera

Platforma do te realizoje llogaritjen e lidhjeve te shkurtra ne Sistemin Elektroenergjetik, bazuar ne modelin e rrjetit. Llogaritjet do te kryhen per lidhje te shkurtra simetrike dhe asimetrike, ne perputhje me metodat:

- AC: IEC 60909 (versioni 2016), IEEE 141 / IEEE 551 / ANSI C37, VDE 0102/0103, IEC 61363
- DC: IEC 61660 ANSI / IEEE 946

Platforma duhet te jete ne gjendje te suportoje metoden e superpozimit, duke perfshire mbeshtetjen dinamike te tensionit I lidhur nepermjet elektronikes se fuqise. Llogaritjen per lidhje te shkurtra shume te shpejta, demtim te celesit te fuqise, nderprerje njefazore, defekte nderqarkore, prishja e kabllit, etj. Rezultatet e lidhjeve te shkurtra duhet te shfaqen ne forme tabelare, sipas llojit te lidhjes se shkurter 1 fazore, 2 fazore, 3 fazore, ose keputje faze.

Analiza e ndjeshmerise se rrjetit

Platforma duhet te kryeje dhe analizen e ndjeshmerise se elementeve te rrjetit, si linja, gjeneratore ose ngarkesa. Faktoret standarte te ndjeshmerise duhet te llogariten si PTDF, LODF, OTDF, PSDF dhe TCDF. Ndjeshmeria mund te llogaritet per elemente te vecante ose per disa elemente ne menyre te njekohshme. Marrja ne konsiderate e kontigjencave. Opsione fleksible raportimi. Analiza Modale per identifikimin e pikave te dobeta dhe te forta te rrjetit.

Modelimi elementeve te Sistemit Elektroenergjetik

Libraria e platformes duhet te jete e madhe dhe te perfshije te gjitha llojet e paisjeve, duhet te ekzistojë mundesia perzgjedhjes se elementeve standarte te rrjetit si :

Linjat e transmetimit me parametra te perqendruar ose parametra te shperndare

Gjeneratore termocentrale, hidro, nukleare, fotovoltaike, me ere etj

Ngarkesa te tipeve te ndryshme, te varura ndaj parametrave elektrike ose te pa varura. Ngarkesa polinomiale.

Makina sinkrone ose asinkrone

Motorre te tipeve dhe fuqive te ndryshme sipas aplikimit me elementet e leshimit te motorrit si inverter.

Transformatore ose autotransformatore, me 2, 3, 4 peshtjella

Transformatore me ndryshim faze (PST)

Pajisje te kompensimit te nivelit te tensionit si shunt reaktore, kapacitore, SVC, pajisje FACTS.

Linja HVDC me rryme te vazhduar ose alternative.

Sistemet e rregullimit si eksitues per njesi gjeneruese konvencionale, rregullatori i tensionit, rregullatori i shpejtesise (RASH). Etj.

Menaxhimi i modeleve te rrjetit

Platforma duhet te kete nje nderfaqe per menaxhimin e skenare te ndryshem te modeleve te rrjetit sipas fazave te zhvillimit te modeleve, si . psh. Te planifikuara, ne operim, te aprovuara, te komisionuara etj. Platforma duhet te kete nje nderfaqe e cila lejon arshivimin e skenareve. Skenaret duhet te jene te

grupueshem dhe te filtrueshem. Skenaret duhet te jene te eksportueshem per aplikime nga perdorues te tjere te cilet zoterojne te njejten platforme. Duhet te kete mundesi per enkriptimin me fjalekalim te bazes me te dhena te skenareve. Platforma duhet te kete nje dritare te pergjithshme te projektit per nje menaxhim me te thjeshtuar te konfigurimit te rastit studimor. Duhet te kete te mundur zhberjen dhe rikthimin e funksioneve te databazes.

Raportimi dhe vizualizimi

Platforma duhet te suportoje nje game te gjere te madhesive elektrike, si rryma, tensioni, fuqia aktive, fuqia reaktive, fuqia e plote, frekuenca etj. Raportimi rezultateve mund te behet ne dritaren e vete platformes ose ne formate jashtme te ekstraktueshme si excel ose PDF. Softueri duhet te permbaje raporte tabelare të integruara për funksione të specializuara dhe lehtësoje pamjet tabelare të rezultateve përmes faqeve të konfigurueshme të të dhënave fleksibel.

Te gjithë skemat duhet te jene te eksportueshme ne formate per perpunim te metejshem. Softueri duhet te ofroje mundesi per vizualizimin e rezultateve në fusha të ndryshme llojit te analizes qe zhvillohet. Skemat e Sistemit elektrik duhet te kene mundesine te shafqen me ngjyra te ndryshme sipas niveleve te tensionit. Gjithashtu ne nderfaqen grafike duhet te shfaqen dhe me shigjeta ose forma te tjera te ngjashme drejtimet e rrymes ose te flukseve te fuqise. Skemat elektrike duhet te kene mundesine e pranimit te koordinatave per qellime te vizualizimit te skemes elektrike me harta. Skemat duhet te jene te eksportueshme ne formate PDF.

Konvertuesi modeleve

Platforma duhet te mundesoje konvertimin e dyanshem te modelve te rrjetit perfshire gjendjen e modelit ne formate te ndryshme te cilat aplikohen ne inxhinierine elektrike si p.sh: ASCII, XML, CSV, ODBC, te suportoje nderfaqjen e GIS dhe SCADA.

- Konvertuesi per data import : PSS/E, UCTE (ENTSO-E), CIM (ENTSO-E Profilet, CGMES 2.4.15 dhe CGMES 3.0) duke perfshire edituesin dhe validuesin e modelit CIM.
- Konvertuesi per data eksport: PSS/E, UCTE (ENTSO-E), CIM (ENTSO-E Profilet, CGMES 2.4.15 dhe CGMES 3.0)

Analiza Kontigjencave

Nje nga komponentet e rendesishme te analizes se Sistemit, eshte analiza e kontigjencave ne Sistemin elektronergjetik. Platforma duhet te simuloje kontigjenca te njepasnjeshme ne SEE, duke kontrolluar plotesimin e kriterit N-1, N-2 apo N-k. Metodatat e analizës se kontigjencave mund te jete duke perdorur metodatat AC ose DC te llogaritjes se flukseve te fuqise. Pas cdo kontigjence ne SEE Platforma duhet te analizoje regjimet pas avari ose pas ndodhjes se kontigjences. Platforma duhet te lejoje ruajtjen e listave te kontigjencave dhe elementeve qe do te monitorohen. Gjithashtu duhet te lejoje implementimin e veprimeve korrigjuese ne pas ndodhjes se kontigjences. Rezultatet e kontigjencave duhet te shfaqen ne forme tabelare ose ne formate te tjera te perpunueshme nga perdoruesi.

Simulimet “Quasi Dinamike”

Duke u bazuar ne metodat llogaritese te shperndarjes se flukseve te fuqise, platforma duhet te kryejë llogaritjen e flukseve te fuqise te shtrira ne kohe, me intervale kohore. Rrjedhimisht duhet te lejoje vendosjen e vlerave te fuqise aktive dhe reaktive per njesite gjeneruese ose per ngarkesen sipas profileve te ndryshme. Profilet duhet te aplikohet pas cdo zgjidhje te shperndarjes se flukseve te fuqise. Softi duhet te marre ne konsiderate nderprerjet e planfikuar sipas skedulit te stakimeve. Platforma duhet te permbaje grafiket e simulimit dhe raportet tabelare duke perfshire analizat statistikore.

Analiza Qendrueshmerise se tensionit

Platforma duhet te jete ne gjendje te analizoje qendrueshmerine e tensionit per nyje te ndryshme te modelit. Analiza te cilat duhet te suprohen duhet te realizohen nepermjet metodave te kurbave P-V dhe Q-V. Per secilen nga analizat duhet te shfaqen rezultatet ne forme tabelare dhe grafike.

Kurbat duhet te jene te selektueshme per secilin element te modelit ne analize sipas perzgjedhjes se perdoruesit. Per secilen kurbe P-V ose Q-V, duhet te suportohet mundesia e realizimit te kontigjencave. Platforma duhet te lejoje gjetjen e pikes se pa qendrueshme per cdo nyje ne model, e cila do te vleresohet nepermjet “tensionit te pragut”. Gjithashtu duhet te suportojë analizen e kalkulimit te fluksit maksimal qe mund te shkembehët ndermjet zonave duke perfutuar faktoret e shperndarjes se flukseve te fuqise (PTDF) si dhe te lejoje identifikimin e flukseve te fuqise per identifikimin e flukseve qarkulluese (loop flows).

Analiza cilesise dhe harmonikave

Platforma duhet te jete ne gjendje te realizojë llogaritjen e harmonikave te shperndarjes se flukseve te fuqise duke mare ne konsiderate indekset e harmonikave per tensionin dhe rrymen (IEC 61000-3-6, BDEW 2008),injektimet e ndryshme te harmonikave nga burimet e rrymes apo tensionit ,tiristoreve,konverterave PWM por gjithashtu edhe nga ngarkesat jo lineare.Per te bere kete analize softueri duhet te bazohet ne disa indekse te ndryshme te deformimit te harmonikave si THD, HD, HF, THF, TAD, TIFmx te percaktuara sipas standarteve IEEE dhe DIN/IEC.

Platforma duhet te mundesojë analizen Flicker modul i cili duhet te permbaj vleresimin Flicker (IEC 61400-21) dhe sistemin Flickmeter (IEC 61000-4-15).

Nje nga komponentet qe platforma duhet te perfshije per analizen e cilesise eshte edhe “Frequency Sweep” i cili ben analizen e komponenteve te sistemit ne baze te frekuences duke ofruar të dhëna të vlefshme për rezonancat e mundshme në rrjet dhe efektivitetin e masave te ndermara.

Softueri duhet te permbaje per cdo analize modele te ndryshme filtrash parametra per dizenjimin,nderfaqjen dhe raporte verifikimi.

Llogaritja e faktorit K dhe faktoret e humbjeve per transformatorët me dy peshtjella (UL1562, EN 50464-3, EN 50541-2, IEEE C 57 110-1998). Suport per formate te ndryshme filesh si Comtrade, CSV, user-defined, etj. Ndryshimet e tensionit relativ, si dhe grafiket e formes valore.

Gjuhët e programimit

Platforma duhet të suportoje integrimin me gjuhë të ndryshme programimi për qëllime të automatizimit të proceseve të analizës etj. Minimalisht duhet të suportoje gjuhët C dhe Python ose ekuivalent.

Softueri duhet të ketë një dokumentacion të detajuar të skriptimit për Python duke përfshirë përshkrimet e funksionit dhe shembuj të kodit, modulet shtesë për shtrirjen e funksionit nga përdoruesi dhe API (Application Interface): Ndërfaqen C++ për automatizim të plotë të jashtëm.

Mirembajtja

Kontraktori duhet të ofrojë shërbim mirembajtje për funksionalitetet e platformës për 1 vit. Gjate periudhës së mirembajtjes çdo problematike që ka të bëjë me funksionimin e platformës do të raportohet te kontraktori dhe kontraktori duhet të japë zgjidhje brenda një kohe të arsyeshme.

Trajnimi

Kontraktori duhet të ofrojë trajnim për stafin e OST, mbi modulet e platformës së analizës së rrjetit. Trajnimi duhet të zhvillohet në ambientet e OST, në përfundim të trajnimit duhet të leshohet certifikata e trajnimit. Në trajnim do të lejohet të marrin pjesë minimalisht 5 pjesëmarrës nga OST.

Shënim:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo në Specifikat Teknikë ku është cituar standard ndërkombëtar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 39,000,000 (tridhjetë e nente milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të balanceve ku të paktën në dy balance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 7,000,000 (shtate milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- ISO 9001: Per menaxhimin e cilesise, qe ka lidhje me objektin e kontrates;
- ISO 27001: Per menaxhimin e sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit te autorizuar per objektin e prokurimit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë, personel Teknik, prej te pakten 3(tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, te diplomuar ne degët e Inxhinierisë Elektronike ose Informatike dhe te jete i trajnuar per administrim network/rrjeti dhe Firewall.

Per te permbushur kete pike, OE ofertues duhet te disponoje diplomen e punonjesit, certifikimet e trajnimeve te kerkuara, CV, kontraten e punes dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

